



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË  
GRAMSH

Nr. 307/2 prot

Gramsh, më 03/02/2023

**VENDIM**

Nr. 4, dt. 30.01.2023

**Për dhënien në përdorim pa kundërshpërblim të një pjese të objektit me emërtimin “Y”, familjes së shtetasit Sefedin Blogu.**

Këshilli i bashkisë Gramsh në mbledhjen e datës 30.01.2023, pasi mori në shqyrtim Relacionin e paraqitur nga drejtoria e shërbimeve me sipërmarrje, transportit, strehimit dhe emergjencave civile, “Për dhënien në përdorim pa kundërshpërblim të një pjese të objektit me emërtimin “Y”, familjes së shtetasit Sefedin Blogu, banues në fshatin Çekin, Njësia Administrative Pishaj”, bazuar në ligjin nr.22/2018, “Për strehimin social”, nenet 19, 63, 73, të VKM nr.334, dt.12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, si dhe të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, pika 2; neni 54, gërma “e” :

**Vendosi:**

- I. Të miratojë dhënien në përdorim pa kundërshpërblim të ambientit me sipërfaqe 60 m<sup>2</sup> në objektin me emërtimin “Y” me numër pasurie 155/3, Zona Kadastrale 2167, në fshatin Kocaj, për banim familjes së z.Sefedin Blogu.
- II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Sektori i Menaxhimit të Aseteve.
- III. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit të tij nga institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë  
Xhulia Gjini

Konc. Xh. Gjini  
Konf. G. Lena  
Dosja: \_\_\_\_\_  
Afati I ruajtjes: \_\_\_\_\_



Kryetari i Këshillit të Bashkisë  
Greta LENA